



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 422/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), i përbërë nga gjyqtaret: Fejzullah Rexhepi kryesues, Adnan Konushevi dhe Faton Ademi anëtarë, si dhe me pjesëmarrjen e zyrtarit të lart ligjor Kudret Hasani, duke vendosur përkitazi me ankesën e kandidatit për deputet të Kuvendit të Republikës së Kosovës Lulzim Kabashi kandidat për deputet nga koalicioni PDK-AAK-NISMA, paraqitur kundër rezultatit përfundimtar të publikuar nga KQZ-ja me datë 29.06.2017, për Zgjedhjet e Parakohshme Parlamentare, në seancën e panelit të mbajtur me 01.07.2017, mori këtë:

V E N D I M

- I. Pranohet** si e bazuar ankesa e Kandidatit për deputet të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Lulzim Kabashi nga koalicioni PDK-AAK-NISMA,
- II. Urdhërohet** Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) që të rinumëroj vetëm fletëvotimet për kandidatët për deputet nga koalicioni PDK-AAK-NISMA në Vendvotimet 2042a/02D; 2042a/06r; 2007a/03r; 2026a/04d; 2029a/02d; 2068a/02d; 2033a/01r; 2007a/04r; 2042a/22r; 2022a/01d; 2013a/01r; 2042a/07r; 2005x/01r
- III. Rezultati** i cili del pas rinumërimit të kutive të votimeve në Venvotimet si në pikën -II- të këtij dispozitivi, të përfshihen në rezultatin përfundimtar.

A R S Y E T I M

PZAP-i, ka pranuar një ankesë më datë 30.06.2017, nga kandidati për deputet të Kuvendit të Republikës së Kosovës Lulzim Kabashi nga radhët e koalicionit PDK-AAK-NISMA, me të cilën pretendon se nga momenti i shpalljes së rezultateve nga KQZ me datën 29.06.2017 në ora 14:00 dhe me publikimin e rezultateve në web faqen e KQZ-së ka bërë krahasimin në listën e kandidatëve ku ka identifikuar disa mospërputhje me listën e publikuar nga KQZ dhe në kopjet e FRK-vë për kandidatë, ku sipas parashtruesit të ankesës është një dallim në mes të kopjeve dhe QNR-së është se në listat e publikuara janë 109 vota ndërsa në kopjet e FRK-vë pretendon se ka 463 vota. Parashtruesi i ankesës në cilësinë e provës si dëshmi ka bashkangjitur kopjet e FRK-vë për vendvotimet në të cilat pretendon se ka pasur parregullsi.

Formularët e Rezultateve të Kandidatëve të ofruara nga parashtruesi i ankesës lidhur me rastin në fjalë janë formularët e vendvotimeve me numër 2005x/01r ; 2007a/03r/04r ; 2013a/01r ; 2022a/01d ; 2026a/4d ; 2029a/02d ; 2033a/01r ; 2042a/02D/06r/07r/22r ; 2068a/02d

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), i shqyrtoj pretendimet ankimore dhe materialin zgjedhor e pas vlerësimit të gjithanshëm të tyre gjeti se:

ankesa është e bazuar

Paneli gjeti se pretendimet ankimore janë të bazuara, pasi që pas shqyrtimit të provave dhe shkresave të lendes, si dhe nga hetimi i bërë në materialin zgjedhor ka konstatuar se ka mospërputhje të rezultateve të shpallura nga KQZ-ja me Formularët e Rezultateve të Kandidatëve dhe Formularit Përfundimtar të Rezultatit, siç rezulton edhe nga provat e ofruara si dëshmi nga vete pala ankuese, andaj mbi këtë baze dhe në mbështetje të nenit 117.4 të LQP-së PZAP-i urdhëron KQZ-në, që të bëhet rinumërimi i të gjitha fletëvotimeve për kandidatët nga koalicioni PDK-AAK-NISMA në këto vendvotime si në vijim: 2042a/02D; 2042a/06r; 2007a/03r; 2026a/04d; 2029a/02d, 2068a/02d; 2033a/01r; 2007a/04r; 2042a/22r; 2022a/01d; 2013a/01r; 2042a/07r; 2005x/01r dhe rezultati i dalur nga rinumërim të përfshihet në rezultatin përfundimtar të Zgjedhjeve të Parakohshme Parlamentare 2017.

Andaj PZAP nga këto arsye, dhe në mbështetje të nenit 117.4 urdhëron që të bëhet rinumërimi i fletëvotimeve për vendvotimet e lartcekura.

Prandaj më qëllim të evitimit të këtyre lëshimeve të lartë cekura dhe bazuar në nenet 115.1, dhe nenin 119.5 të LQP-së, ku parashihet se, *PZAP-i mundet që sipas vendimit të tij të shqyrtoj çështje të cilat përndryshe janë nën juridiksionin e tij kur kjo është rreptësisht e domosdoshme për të parandaluar padrejtësi serioze* po ashtu lidhur me nenin 118 paragrafi 1 të LQP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

A nr. 422/2017 më datën 01.07.2017.



Kryesuesi i Panelit
Fejzullah Rexhepi

Këshillë Juridike:

Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LQP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve, nga momenti i marrjes-pranimet të këtij vendimi.